

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA
“GJELI ARTE “shpk

Sot me dt .01/02/2017 (2) ortakët

1. DAKLEA ALLKO
2. KADRI ÇELA

Vendosen që në bazë të Ligjit Nr.9901 dat.14.04.2008, “Për Tregëtarët dhe Shoqërit Tregëtare, dhe Ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtar të Rregjistrimit “formohet shoqëria tregëtare me përgjegjësi të kufizuar “ **GJELI ARTE “shpk**, me cilësinë e Ortakeve themelues.

1. **DAKLEA ALLKO** e buja e SHABANIT i datëlindjes.20.02.1987 me karte identiteti **I752200780** lindur ÇORROVODË SKRAPAR banues TIRANË

2. **KADRI ÇELA** i biri HALIMIT i datelindjes 18.01.1966 me karte indentiteti **G60118153L** lindur dhe banues ne KAVAJË Lagja Nr.5 shprehen vullnetin për hartimin e këtij Akt Themelimi te shoqërise “**GJELI ARTE “shpk** si me poshtë

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqëria “**GJELI ARTE ” shpk** është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në **QKR**, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “**GJELI ARTE “ shpk**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga **1.z.DAKLEA ALLKO 2.z. KADRI ÇELA** te cilet përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortakët gëzojnë kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka seline ne **Lagjen Nr.1 Kavaje (mbas hekurudhes) godine nje kateshe me numer 55**

Shoqëria mund te ndryshojë seline e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- **IMPORT-EKSPORT** i kafshëve të gjalla, mbarshtim zogjësh për mish e vezë ,zogjë 24 orësh ,vezë për inkubator ,zoga për vezë etj.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do te zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhe kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II
KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërise është 10.000.000(Dhjetemiljon te reja) lekë

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga "ortaket " e shoqërise :

Kapitali do te paguhet nga ortaket me para kesh ne banke

1. DAKLEA ALLKO zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme

5.000 000 (Pesemiljon te reja) Leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqërise

z.2. KADRI ÇELA zoterues i 1 kuote me vlerë te përgjithshme 5.000 000 (Pesemiljon te reja) Leke, qe perben 50 % te kapitalit themeltar te shoqërise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqërise perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqërise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

ASAMBLEJA E ORTAKEVE eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërise.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE eshte organi vendimmarres i shoqërise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqërise.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga **ASAMBLEJA E ORTAKEVE** regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë DAKLEA ALLKO i datelindjes 20.02.1987 me karte indentiteti **I752200780** emruar në këto detyra për një afat 5 vjeçar me të drejta ripërteritje.

Administratori emrohet dhe shkarkohet me **vendim të Asamblesë së Ortakeve të shoqërisë.**

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që **aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,**

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i

administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetëm;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këto raste ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tyre emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 2 kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mesipër pasi miratohet në parim dhe nën nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare “**GJELI ARTE**” shpik nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale .

ORTAKET

1. **DAKLEA ALLKO**

2. **KADRI ÇELA**

